



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR ELBASAN

NR.REGJ.THEM. 627 (61005-02049-13)
Date 29.07.2016

NR. VENDIMIT 627 (13-2016-4115)
Date 30.07.2016

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Elbasan, me trup gjykues te perbere nga:
Gjyqtar *TOMORR KULLOLLI*

Asistuar prej sekretares Klodiana Ulorja mori ne shqyrtim ne séance gjyqesore me dt.30.07.2016, kerkesen e paraqitur nga :

KERKUES: Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan, perfaqesuar nga prokurori Fatmir Lushi.

OBJEKTI I KERKESES : Vendosjen e mases sigurimit e sekuestros preventive

BAZA LIGJORE : Neni 274 i K.Pr .Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kerkesen e prokurorit dhe provat bashkengjitur kerkeses, qe ne perfundim prokurori kerkoi pranimin e saj ;

V E R E N

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka regjistruar procedimin penal nr.1271 të vitit 2016, për kryerjen e vepres penale të "Fallsifikim dokumenti" nga personi qe ka per detyre leshimin e tij dhe "Shperdorim detyre", parashikuar nga nenet 186/3 dhe 248 i Kodit Penal.

Nga hetimet mbi faktin, deri ne kete faze ne te cilen ndodhen hetimet, ka rezultuar se:

Pasardhesit e te ndjerit Azem Hysen Floqi (vdekur ne vitin 1975), shtetasit Lutfije Floqi (Zabzuni), Ikbal Floqi, Ruzhdi Floqi, Rifat Floqi, Engjellushe Floqi, Hysen Floqi, Emine Floqi, Gentian Floqi dhe Belerina Floqi kane perfituar te drejten e kompensimit ne nje shume prej 32.901.750 leke, nga buxheti i shtetit. Vlera prej 57 % e kesaj shume iu eshte dhene.

Shtetasit e lartpermendur dyshohet se e kane perfituar ne menyre te jashteligjshme nje siperfaqe toke prej 4.200 m², ne baze te "Akti i Marrjes se Tokes

idini, me
ujtim
m

Ne kete vertetim emri Azem eshte i korrigjuar, ku ne dukje poshte ka qene shenuar Avram.

Ky vertetim eshte perdorur ne Gjykatën e Shkalles se Pare Elbasan, ne gjykim, me objekt vertetim fakti juridik mbi pronesine, nga trashegimtarja e Azem Floqi, shtetesja Ikkal Floqi. Gjykata e Shkalles se Pare Elbasan me vendimin nr.33, date 13.01.1995 ka bere vertetimin e faktit juridik.

Me date 12.04.1994 Ikkal Floqi i eshte drejtuar Zyres Rajonale te Kthimit dhe Kompensimit te Pronave Elbasan, duke kerkuar njohjen dhe kompensimin e prones, ku per kete shtetase eshte hapur dosja me nr.674, date 12.04.1994. Ikkal Floqi ka perdorur vertetimin e leshuar nga Bashkia Elbasan dhe vendimin gjyqesor te sipercituar. Nga ana e kerkuesit nuk eshte plotesuar dokumentacioni i dosjes sikurse kerkonte ligji ne fuqi.

Me vendimin nr.268, date 16.07.2008 Z.R.K.K.P Elbasan ka vendosur mbylljen e procedimit per shqyrtimin e dosjes me nr.674, date 12.04.1994.

Me vendimin nr.3039/3, date 16.1.2009, Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit te Pronave ka vendosur te mos njohe te drejten e pronesise se kerkuesit Ikkal Floqi.

Nga permbajtja e vendimit nr.40, date 17.04.1964, te Komitetit Ekzekutiv te K.P. Qytetit, nxjerre nga Arkivi Shteteror, Zyra Vendore Elbasan, i cili nuk duket mire, nuk rezulton qe ne permbajtje te ketij vendimi te jete emri i Azem Floqit, por Avram Floqi, si person i shpronesuar.

AMTP nr.94, pa date, eshte paraqitur per t'u rregjistruar ne ZVRPP Elbasan, me date 22.07.2007, nga trashegimtarët e familjes Floqi se bashku me plan rilevimin.

Me date 10.09.2007 rregjistruesi Nazmi Dervishi ka urdheruar rregjistrimin e pasurise me nr.4/143 ne me rte Lutfie Floqi etj dhe mbylljen e pasurise me nr.4/68, vol 9, fq 123.

Agjenisa e Kthimit dhe Kompensimit te pronave me shkresen me nr.1618/1 prot, date 29.04.2015 konfirmon se Keshilli i Ministrave, me vendimin nr.120, date 17.02.2011 ka vendosur te miratoje shperblimin per pasurine me nr.4/142, ndodhur ne z.k 8523, Elbasan, prone e zene me ndertime informale, ne shumen e pergjithshme prej 32.901.750 leke. AKKP ka hapur dosjen me nr.213-A, date 19.09.2011. Me vendimet nr.1380, date 16.12.2011, nr.1399, date 23.12.2011 dhe nr.858, date 07.06.2013 te AKKP-se eshte vendosur kalimi i keshtit te kompensimit prej 57% te vleres totale ne llogarine bankare te perfaqesueses me prokure znj.Lutfije Azem Zabzuni, shuma 6 974 837 leke..

Pasurite qe figurojne ne emer te trashegimtareve Floqi fituar ne baze te AMTP nr.94, date ska jane 4/265, zk 8523 dhe pasuria nr.4/267 zk 8523.

Sa me lart provohet me: -Akti i Marrjes se Tokes ne Pronesi (AMTP) Nr. 94 date s'ka, Vendim i Keshillit te Ministrave (VKM) Nr. 120 date 17.02.2011, shoqeruar

date 16.05.2011,
plan-vendosjen
eruar me listen e per
ndim Gjykate Shkryerje
irres nr. 10-2014-25
'/3, date 07.01.2015
tim nr.157, date
sise (K.V.T.P.)
vendimit nr.
Gjykates
et dhe
ate

disponimi i lirë i dokumentacionit të kësaj prone, që lidhet me veprën mund të sjellë transaksione, transformimin ose shndërrimin e saj në tjerë me qëllim moskthimi apo fshehje të të ardhurash ose të sherbeje veprash të tjera penale, ndaj është i nevojshëm caktimi nga Gjykata i së sigurimit pasuror "Sekuestro Preventive" parashikuar nga neni 274 i Penale, masë sigurimi kjo e përshtatshme në raport me rëndësinë e faktit.

Ne keto kushte prokurori kërkoj caktimin e masës së sigurimit "Sekuestro preventive", duke vendosur sekuestro mbi Pasurite që figurojnë të rregjistruara në emër të trashëgimtareve Floqi (fituar në baze të AMTP nr.94, date ska) , konkretisht për pasurite me nr. 4/265, zk 8523 dhe pasuria nr.4/267 z.k 8523.

Te urdherohet ZVRPP Elbasan për moskryerjen e asnjë veprimi ligjor në lidhje me keto pasuri deri në perfundim të hetimeve.

Nisur sa me sipër Gjykata çmon se kërkesa e prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan është e drejtë dhe e bazuar në ligj, neni 274 i K.Pr.Penale dhe në provat e permendura më lart dhe si e tillë duhet pranuar, me qëllim kryerjen e një hetimi të plotë e të gjithanshëm të kësaj çështjeje, pasi kemi të bëjmë me një veprë penale me rrezikshmeri të lartë shoqërore dhe ky lloj sekuestrimi për këto veprë penale parashikohet shprehimisht në nenin 274 të K.Pr.Penale

PER KETO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 274 të K.PR.Penale.

V E N D O S I

-Pranimi i kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

-Sekuestrimin e pasurisë nr.4/265, ZK 8523 dhe pasurisë nr.4/267, ZK 8523, që rezultojnë të regjistruara në ZVRPP Elbasan në emër të trashëgimtareve "Floqi" fituar në baze të AMTP nr.94, date ska).

-Urdherohet ZVRPP Elbasan të mos kryejë asnjë veprim në lidhje me keto pasuri deri në perfundim të hetimeve.


-Kunder këtij vendim mund të bëhet ankim sipas ligjit .

-U shpall në Elbasan sot më datë 30.07.2016

SEKREJTARE
KLODIAN KULLORJA



GJYQITAR
TOMORR KULLOLLI



Vërtetohet se ky akt është i njëjti me origjinalin që ndodhet në arkiv. Dë 23/11/2016

